



RAPORT I SEANCËS **(Seanca e 81-të , mars 2015)**

Gjatë seancës së tij të mbajtur në mars 2015, [Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut](#) (Paneli) miratoi katër mendime lidhur me katër ankesa. Mbesin 73 ankesa në pritje pranë Panelit. Statistikat e plota mund të gjinden këtu në [anglisht](#), [shqip](#) dhe [serbisht](#). Më poshtë janë përmbledhjet e mendimeve të miratuara; teksti i plotë i tyre do të publikohet në uebsajtin e Panelit përafësisht brenda një muaji.

Sava JOVANOVIÇ kundër UNMIK-ut (lënda nr. 213/09)

Ankuesi është djali i z. Jovan Jovanović, i cili u rrëmbye nga shtëpia e tij në fshatin Leshan, komuna e Suharekës, regjioni i Prizrenit, nga pjesëtarë të UÇK-së në një datë ndërmjet 11 dhe 13 qershorit 1999. Që nga ajo kohë vendndodhja e tij mbetet e panjohur.

Paneli konstatoi se UNMIK-u nuk zbatoi hetim të efektshëm për rrëmbimin dhe zhdukjen e z. Jovan Jovanović, duke shkelur kështu obligimin procedural të nenit 2, KEDNJ, dhe se me sjelljen e tij, UNMIK-u kontribuoi në ankthin dhe vuajtjet mentale të ankuesit, duke përbërë shkelje të nenit 3 të KEDNJ.

Vlainka RISTIÇ kundër UNMIK-ut (lënda nr. 269/09)

Ankuesja është bashkëshortja e z. Srba Ristiç, i cili u zhduk më 13 korrik 1999 nga fshati Strezovc, komuna e Kamenicës. Që nga ajo kohë vendndodhja e tij mbetet e panjohur.

Paneli konstatoi se UNMIK-u nuk zbatoi hetim të efektshëm për zhdukjen e z. Srba Ristiç. Prandaj ka pasur shkelje të nenit 2, obligimit procedural të KEDNJ. Paneli po ashtu gjeti se me sjelljen e tij UNMIK-u kontribuoi në ankthin dhe vuajtjet mentale, duke përbërë shkelje të nenit 3 të KEDNJ.

Nebojsa GRUJIÇ kundër UNMIK-ut (lënda nr. 287/09)

Ankuesi është djali i z. Branislav Grujiç, i cili u rrëmbye nga automjeti i tij nga persona të panjohur në Pejë, më 18 qershor 1999, derisa ai ishte duke u përpjekur të gjejë nipin e tij z. Milorad Grujiç, i cili po ashtu ishte i zhdukur. Z. Branislav Grujiç asnjëherë më nuk u pa i gjallë. Më 1 prill 2005, UNMIK-u ua ktheu mbetjet e tij mortore anëtarëve të familjes.

Paneli konstatoi se UNMIK-u nuk zbatoi hetim të efektshëm për rrëmbimin dhe vrasjen e z. Branislav Grujiç, duke shkelur obligimin procedural në nenin 2 të KEDNJ.

Zorica STANKOVIÇ kundër UNMIK-ut (lënda nr. 304/09)

Ankuesja është bashkëshortja e z. Miodrag Stankoviç, i cili u rrëmbye më 23 qershor 1999, nga pjesa e jashtme e banesës së tij në Pejë nga persona të panjohur. Që nga ajo kohë, vendndodhja e tij mbetet e panjohur.

Paneli konstatoi se UNMIK-u nuk zbatoi hetim të efektshëm për rrëmbimin dhe zhdukjen e z. Miodrag Stankoviç, duke shkelur nenin 2, obligimin procedural të KEDNJ. Paneli po ashtu gjeti se me sjelljen e tij UNMIK-u i kontribuoi ankthit dhe vuajtjeve mentale të ankuseses, duke përbërë shkelje të nenit 3 të KEDNJ.

Ky raport është dokument i përgatitur nga Sekretariati i Panelit. Ai nuk e obligon Panelin. Vendimet, mendimet dhe informacionet tjera për Panelin mund të gjinden në www.unmikonline.org/hrap

Paneli u themelua në Prishtinë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në vitin 2006 për të trajtuar shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut.